



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 5. 3.2013, e cila filloi në orën 15:00.**

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Engin Beyoglu, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

**Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.**

**Njëzëri u miratua ky**

### **REND DITE :**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë;**
- 2. Raporti vjetor për vitin 2012.**
- 3. Raporti i punës për vitin 2012 i NPR “ Pastrimi”;**
- 4. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Hortikultura”;**
- 5. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK “Trafiku Urban”;**
- 6. Propozimvendimi mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndërtimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013;**
- 7. Të ndryshme.**

**Pika e parë**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë.**

**Pika e dytë**

**Arsyetimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Avdullah Hoti.****

**Aziz Pacolli** tha se është mirë që të gjendet një objekt për Shkollën e muzikës, sidomos për klasat e ulëta, pasi që nxënësit i kanë shkollat afër dhe nuk është mirë të largohen shumë, sidomos duke marrë parasysh orarin e papërshtatshëm dhe bartjen e instrumenteve. Ai gjithashtu shtoi se ishte i paraparë ndërtimi i pesë rrugëve në fshatin Marec, andaj shtroi pyetjen se çka ka ndodhur me to.

### **Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.**

**Tefik Mehmeti** tha se është një raport shumë i përgjithësuar, që jep një pasqyrë të përgjithësuar të projekteve të realizuara, por edhe të atyre që do të realizohen. E veçanta e këtij raporti është sukcesi i ekzekutivit lidhur me të hyrat, por edhe , ngritja e përgatitjes shkollore të punëtorëve në administratë. Për këtë vetëm mund ta përgëzoj ekzekutivin.

**Milazim Vitia** e përkrahu raportin, duke shtuar se në Sektorin e bujqësisë vitin e kaluar është bërë një punë e mirë në ndihmën e fermerëve dhe bletarëve, ndërsa këtë vit nuk është paraparë buxhet për vaksinimin e kafshëve. Ai gjithashtu shtoi se duhet stimuluar bujqit, sidomos në prodhimin e qumështit, dhe duhet bërë vaksinimi pranveror i kafshëve. Kërkoj që të parashihet vendi i punës së një tekniku medicinal në Ambulancën në Flotacion, si dhe ndërtimi i një shtëpie të kulturës, një fushe sportive dhe ndërtimin e rrugës së paku me zhavorr.

**Shefqet Sylejmani** u shpreh se në raport janë disa çështje që është dashtë të paraqiten më gjerësisht, sidomos në pjesën e punëve të ekzekutivit, qoftë për sukses ose mossukses. Përndryshe, raporti është i suksesshëm dhe është për t'u përshëndetur puna e bërë, edhe pse në mungesë të Ligjit për Prishtinën dhe policisë komunale, me probleme të shumta të trashëguara para dhe pas luftës. Do të ishte mirë të thuhet edhe për ankesat që i bëjmë, rezultatet dhe sukseset. Me këtë nivel të menaxhimit në qytetit, kur çdo gjë udhëhiqet nga niveli qendror, ka probleme që dikush duhet t'i ketë parasysh. Megjithatë, është punuar dhe është duke u punuar në Prishtinë. Nuk po i shprehim bindshëm dhe arsyeshëm pengesat dhe vështirësitë. Nuk ka vend për vetëkënaqësi dhe duhet të punohet edhe më shumë në çdo lëmë.

**Kryesuesi** tha se është arritur një funksionalitet më i mirë i administratës, por vërejtje ka në punën e komiteteve, të cilat nuk paguhen, ndërsa sa i përket shpenzimeve buxhetore, kanë arritur nivelin prej 80% në krahasim me mjetet e planifikuara për t'u shpenzuar. Shpenzimi i buxhetit është realizuar sipas alokimit të mjeteve dhe rrjedhës së parasë së gatshme, duke përfshirë fondin burimor nga granti dhe të hyrat vetanake. Është një menaxhim i mirë i parasë dhe i strukturuar shumë mirë, andaj e përkrah në tërësi.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Raporti vjetor për vitin 2012 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e tretë , e katërt dhe e pestë**

**Aziz Pacolli** tha se në të tri ndërmarrjet shihet një përparim i punëve, sidomos në atë "Pastrimi", ku është ndërruar struktura dhe çdo gjë është në rregull. Kërkoj që NPK "Trafiku Urban" këtë vit të marrë ndihmë nga Komuna dhe autobusët e qytetit të ndërrohen të gjithë. Kërkoj që të rregullohet qarkullimi i linjës nr. 4 dhe 5, që qojnë për në Gërmi, pasi që të njëjtit lëvizin shumë ngadalë dhe prapa tyre bëhen kolona të gjata automjetesh.

**Kryesuesi** paraqiti disa sqarime shtesë.

**Tefik Mehmeti** tha se kemi shumë më tepër shënime sesa që duhet të kemi dhe këto raporte janë shumë të ngarkuara. Lidhur me deponinë në Mirash, tha se duhet të ketë një marrëveshje mirëkuptimi në mes të saj dhe NPR "Pastrimi" për pagesën, në bazë të përqindjes së arkëtimit të NPR "Pastrimi", t'i paguhet edhe deponisë në Mirash, ndërkaq për raste sociale dhe kategoritë tjera, pagesën ta bartë Ministria përkatëse.

**Njëzëri u konstatua se u përkrahën Raportet e punës për vitin 2012, i NPR "Pastrimi", NPK "Hortikultura" dhe NPK "Trafiku Urban" dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim.**

### **Pika e gjashtë**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Bexhet Musliu**.

**Mustafë Krasniqi** pyeti se taksat administrative në vlerë prej 9,96 €, a vlejnë për të gjitha kategoritë e banesave kolektive, individuale dhe të bizneseve. Në pikën VII, paragrafët: a,b,c, dhe d, të ngrihet përqindja për 10%.

**Kryesuesi** propozoi që të stimulohet ndërtimi nën tokë dhe të mos ngarkohet me taksa.

**Bexhet Musliu** paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

**Aziz Pacolli** kërkoj sqarim lidhur me pikën VII dhe shtoi se më parë objektet individuale të banimit kanë qenë të parapara deri në 450 m<sup>2</sup>, ndërsa tani 350 m<sup>2</sup> dhe pyeti se a mbetet përsëri sipërfaqja deri 450 m<sup>2</sup>.

Në pyetjen e parashtruar u përgjigj **Bexhet Musliu**.

**Tefik Mehmeti** tha se neni 2 është i paqartë, andaj kërkoi sqarim. Në nenin 8, shuma prej 100 000 €, propozoi të jetë 50 000 €.

**Mustafë Krasniqi** pyeti se personat të cilët kanë aplikuar për objekte individuale të banimit në kohën kur ka qenë e paraparë sipërfaqja prej 450 m<sup>2</sup>, ndërsa tani parashihen 350 m<sup>2</sup>, cila sipërfaqe do të iu llogaritet.

**Bexhet Musliu** paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

**Kryesuei** paraqiti sqarime përkitazi me nenin 10, për të cilin tha se duhet përmirësuar. **U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi mbi taksat administrative për infrastrukturës për vitin 2013, me ndryshime dhe plotësime, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

**Pika e tetë**

Të ndryshme

**Shefqet Sylejmani** luti anëtarin e Komisionit, z. Bexhet Musliu, i caktuar nga Kryetari i Komunës, ta finalizojnë punën lidhur me ndarjen e pronës që i takon

Komunës nga pjesa e pronës së investitorit – ndërmarrjes “Stan-glob” që ishte koncesionar në ndërtimin e kompleksit banesor “Dielli” në lagjen “Kodra e Diellit”. Me këtë do të mundësoheshin edhe veprimet e duhura dhe të nevojshme për dhënien e lejes për përdorim - shfrytëzim nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

*Mbledhja mbaroi në orën 17:15.*

**PROCESMBAJTËSE:**

**Alije Gusia**

**KRYESUESI I KOMITETIT**

**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**